

KUSHTET E PËRDORIMIT TË FAQES

WWW.RATECH.AL

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Ju duhet t'i lexoni me kujdes këto kushte të përdorimit të faqes ("kushtet"). Hyrja dhe përdorimi juaj nga ana juaj e faqes së internetit të RATECH sh.p.k. ("RATECH"), www.ratech.al, rregullohen nga këto kushte, të cilat përbëjnë një kontratë të ligjshme dhe detyruese mes jush dhe RATECH. Marrëdhënia juaj me RATECH rregullohet edhe nga "Politika e Privatësisë së RATECH sh.p.k.", e cila ndodhet gjithashtu e postuar në këtë faqe.

1.2. Duke hyrë ose duke përdorur në çdo mënyrë këtë faqe, ju pranoni detyrueshmërinë e këtyre kushteve. Këto kushte mund të ndryshojnë herë pas here, sipas diskrecionit të RATECH, dhe përdorimi nga ana juaj i faqes pas ndryshimeve të kushteve do të përbëjë dakordësinë tuaj me kushtet e ndryshuara. Nëse nuk jeni dakord me kushtet, ju nuk mund të aksesoni ose të përdorni faqen.

2. AKSESI

2.1. Përveç nëse specifikohet ndryshe, faqja ka për qëllim të përdoret vetëm prej jush dhe agjentëve tuaj të autorizuar. Duke hyrë në faqe, ju pranoni dhe konfirmoni se jeni i autorizuar të përdorni dhe të aksesoni faqen.

3. E DREJTA E AUTORIT

3.1. Dizajni, teksti dhe grafikati e faqes, si dhe zgjedhja dhe renditja e këtyre elementëve janë të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe nga ligjet dhe traktatet për të drejtat e autorit në të gjithë botën.

3.2. Në qoftë se nuk parashikohet ndryshe në faqe, të gjitha shenjat dhe logot e kompanive, produkteve dhe shërbimeve të shfaqura në faqe u nënshtrohen të drejtave të markave tregtare të RATECH, kompanive të lidhura me të ose partnerëve të saj të biznesit.

3.3. Ju jeni të detyruar:

3.3.1. të mos hiqni ose shkatërroni shenjat e të drejtave të pronësisë apo legjendat shpjeguese që ndodhen në faqe;

3.3.2. të mos modifikoni, përmirësoni, përshtasni, përktheni ose krijoni punë që rrjedhin nga përmbytja e faqes;

3.3.3. të mos ribotoni, postoni, transmetoni, transferoni, shpërndani, caktoni, jepni me licencë sekondare, merrni ose jepni me qira ose shisni faqen;

3.3.4. të mos dekompononi, çmontoni ose kryeni *reverse engineering* me faqen, në mënyrë që të ndërtoni një produkt ose shërbim konkurrues, të ndërtoni një produkt duke përdorur ide, karakteristika, funksione ose grafika të ngjashme me ato të faqes, ose të kopjoni ndonjë ide, tipar, funksion ose grafikë të faqes;

3.3.5. të mos riprodhoni ose bëni kopje të faqes;

3.3.6. të mos kopjoni ose pasqyroni faqen në ndonjë server apo pajisje tjetër të bazuar në internet;

3.3.7. të mos aksesoni, shikoni, shkarkoni, printoni, përdorni ose shfaqni faqen për ndonjë qëllim tregtar ose qëllim tjetër për të bërë para;

3.3.8. të mos përdorni mjete që mbledhin të dhëna (*data mining*), robotë ose mjete të tjera të ngjashme për mbledhjen ose nxjerrjen e të dhënave;

3.3.9. të mos përdorni etiketime "meta" ose tekste të tjera të fshehura duke përdorur emrin ose markat tregtare të RATECH pa miratimin tonë të shprehur me shkrim.

3.4. Përveç sa parashikohet shprehimisht këtu, RATECH nuk ju jep ndonjë të drejtë të shprehur ose të nënkuptuar që rrjedh nga ndonjë patentë, e drejtë e autorit, markë tregtare ose informacion sekret tregtar. Ju mund të shkarkoni dhe printoni kopje të seksioneve të faqes gjetëm për përdorimin tuaj të brendshëm.

4. PËRMBAJTJA QË VJEN NGA PËRDORUESIT

4.1. Në përputhje me këto kushte, përdorues të caktuar mund të dërgojnë tekst, të dhëna, informacione dhe përmbajtje me natyrë tjetër përmes faqes sonë. RATECH ka të drejtën (por jo detyrimin), bazuar vetëm në gjykimin tonë, për të verifikuar paraprakisht, refuzuar ose hequr çdo përmbajtje që është vënë në dispozicion përmes faqes.

4.2. Ju jeni përgjegjësitet e vetëm për përmbajtjen që dorëzoni dhe pasojat e dorëzimit të saj. Duke dorëzuar çfarëdo përmbajtje, ju pohoni, përfaqësoni dhe garantoni se:

4.2.1. zotëroni licencat, të drejtat, pëlqimet dhe lejet e nevojshme për të përdorur dhe autorizuar RATECH të përdorë çfarëdo përmbajtjeje, në mënyrat e parashikuara në këto kushte;

4.2.2. përmbajtja nuk çënon dhe nuk do të çënojë, nëpërmjet shkeljes ose keqpërdorimit, ndonjë pronësi intelektuale ose të drejta të tjera të pronësisë së palëve të treta.

4.3. Duke dërguar përmbajtjen, ju bini dakord që përmbajtja e dërguar prej jush të transferohet dhe të përpunohet në Shqipëri. Ju jeni përgjegjësitet i vetëm për çdo përdorim të përmbajtjes dhe duhet të mbani të gjitha rreziqet që lidhen me të, përfshirë saktësinë, plotësinë ose dobinë e saj. Ne nuk duam të marrim prej jush informacione konfidencial ose që kanë të drejta autori, përmes kësaj faqeje ose me email. Në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim nga një punonjës i autorizuar i RATECH, çdo material, informacion ose ide që i transmetoni RATECH ose faqes, me çfarëdo mjeti, mund të shpërndahet ose të përdoret nga RATECH pa kompensim ose përgjegjësi ndaj jush për çfarëdo qëllimi, përfshirë, por pa u kufizuar tek zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i produkteve.

4.4. Ju nuk do të dorëzoni përmbajtje që është e mbrojtur nga e drejta e autorit, sekreti tregtar ose e drejta e pronësisë së palëve të treta, duke përfshirë të drejtat e konfidencialitetit dhe publikimit, përveçse nëse i zotëroni vetë këto të drejta ose keni autorizim nga mbajtësi i tyre për ta dorëzuar përmbajtjen dhe për t'ia kaluar këto të drejta RATECH.

4.5. Ju i ruani të drejtat e pronësisë mbi përmbajtjen që dorëzoni. Sidoqoftë, duke dorëzuar ndonjë përmbajtje në faqe, ju i jepni RATECH të drejta të vlefshme në të gjithë botën, jo ekskluzive, pa detyrim për pagesë dhe të transferueshme për të përdorur përmbajtjen siç parashikohet nga këto kushte.

4.6. Ju pranoni se NUK do ta përdorni këtë faqe për të:

4.6.1. ngarkuar, postuar, dërguar me email ose transmetuar në mënyra të tjera përmbajtje që është e paligjshme, e rremë, mashtruese, e dëmshme, kërcënuese, abuzive, ngacmuese, torturuese, fyese, vulgare, e pahijshme, pornografike, shpifëse, me urrejtje, që ndërhyjnë në privatësinë e tjetrit ose që mund të

NUIS: L11521021S

kundërshtohet për arsye raciale, etnike ose të tjera ose përmbajtje që mund të përbëjë ose inkurajojë sjellje që do të konsideroheshin vepër penale, që do të sillnin përgjegjësi civile ose do të shkelnin ndonjë ligj;

4.6.2. dëmtuar të miturit në çfarëdo mënyre;

4.6.3. ngarkuar, postuar, dërguar me email ose transmetuar në mënyra të tjera përmbajtje që nuk keni të drejtë të ngarkoni, postoni, dërgoni me email ose transmetoni ndryshe, bazuar në ligj ose në marrëdhënie kontraktore ose fiduciare;

4.6.4. ngarkuar, postuar, dërguar me email ose transmetuar në mënyra të tjera reklama të pakërkuara ose të paautorizuara, materiale promovuese, emaile *junk*, emaile masive të pakërkuara, emaile *spam*, emaile zinxhir ose çdo formë tjetër të reklamimit tregtar;

4.6.5. ngarkuar, postuar, dërguar me email ose transmetuar në mënyra të tjera përmbajtje që përmban viruse ose ndonjë kod tjetër kompjuterik, skedarë ose programe të dizajnuara për të ndërprerë, shkatërruar ose kufizuar funksionalitetin e çdo programi ose pajisjeje kompjuterike ose telekomunikuese;

4.6.6. ndërhyrë ose prishur këtë faqe ose serverat ose rrjetet e lidhura me këtë faqe ose shkelur kërkesat, procedurat, politikat ose rregulloret e rrjeteve të lidhura me faqen;

4.6.7. shkelur me ose pa dashje ligjin e zbatueshëm;

4.6.8. përndjekur ose ngacmuar në mënyra të tjera përdorues të tjerë të kësaj faqeje;

4.6.9. grumbulluar ose ruajtur të dhëna personale për përdoruesit e tjerë të faqes;

4.6.10. kërkuar fjalëkalime ose të dhëna personale identifikuese nga përdorues të tjerë për qëllime tregtare ose të paligjshme;

4.6.11. ndihmuar ose lejuar persona të tjerë të kryejnë ndonjë nga aktivitetet e përshkuara më sipër.

5. PËRMBAJTJA E FAQES

5.1. Ju mund të shihni ose të lexoni në faqen tonë përmbajtje që nuk ju pëlqen apo me të cilën nuk bini dakord. Ju pranoni që, duke përdorur faqen tonë, mund të ekspozoheni ndaj përmbajtjes që është fyese, e pahijshme ose e kundërshtueshme. Në asnjë rrethanë, ne nuk do të mbajmë asnjë lloj përgjegjësie për përmbajtjen, përfshirë, por pa u kufizuar tek gabimet ose mangësitë në përmbajtje ose tek humbjet ose dëmet e çfarëdo lloji, të shkaktuara si rezultat i përdorimit të çdo përmbajtjeje të postuar ose transmetuar përmes faqes sonë. Ju pranoni që ne nuk kemi asnjë detyrim për të verifikuar përmbajtjen përpara postimit, megjithëse ne rezervojmë të drejtën që, bazuar vetëm në gjykimin tonë, të refuzojmë, të zhvendosim ose të fshijmë çfarëdo përmbajtje.

6. TË DREJTAT

6.1. RATECH ju jep dhe ju pranoni prej tij të drejtën personale, të revokueshme, jo ekskluzive dhe të patransferueshme për të aksesuar dhe përdorur faqen vetëm për qëllime personale ose të brendshme të biznesit dhe jo për rishpërndarjen, ritregtimin, veprimtarinë e një pale të tretë ose ndonjë përdorim tjetër.

6.2. RATECH rezervon të gjitha të drejtat që nuk ju janë dhënë shprehimisht në këto kushte. Ju pranoni që të drejtat që ju janë dhënë në këto kushte nuk ju transferojnë ndonjë titull ose ndonjë të drejtë të pronësisë intelektuale mbi faqen ose mbi cilëndo nga pjesët e përmbajtjes së saj.

7. TË DHËNAT PERSONALE

7.1. RATECH mund të përdorë të dhëna të marra nga aksesimi dhe përdorimi i faqes në tërësi. Ju pranoni që këto të dhëna janë me natyrë përmbledhëse dhe nuk janë nuk janë të dhëna personale të identifikueshme.

8. TË DHËNAT E PALËVE TË TRETA

8.1. Faqja mund të përmbajë lidhje elektronike me faqe të tjera, të cilat janë përtej kontrollit të RATECH. RATECH nuk është përgjegjës për përmbajtjen e faqeve të lidhura ose të lidhjeve që përmbahen në faqet në pronësi ose nën kontrollin e një pale të tretë. RATECH rezervon të drejtën të ndërpresë çdo lidhje ose program që krijon lidhje në çdo kohë. RATECH i ofron lidhjet elektronike vetëm si lehtësi për ju. RATECH nuk ka mbështetur, testuar ose verifikuar ndonjë informacion, program, kompani ose produkt në faqet, me të cilat krijohen lidhje elektronike në faqen tonë. Nëse vendosni të përdorni ndonjë faqe të palëve të treta, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur në faqen tonë, ose t'i jepni asaj të dhëna personale të identifikueshme, ju e bëni këtë duke iu nënshtruar kushteve dhe politikave të zbatueshme për ato faqe.

8.2. RATECH mund të ofrojë në këtë faqe informacion që vjen nga palë të treta. Përveç aty ku kjo deklarohet shprehimisht, RATECH nuk përfaqëson, miraton ose garanton saktësinë, plotësinë, kohën e duhur, besueshmërinë ose përshtatshmërinë e çfarëdo informacioni të siguruar nga palët e treta. Ju pranoni që RATECH nuk është përgjegjës për informacionin e palëve të treta, të cilin ju e merrni përmes kësaj faqeje, duke përfshirë mendimet, këshillat, deklaratat dhe reklammat, dhe se ju i përdorni informacione të tilla nën përgjegjësinë tuaj.

9. GARANCITË

9.1. RATECH ju siguron aksesin këtë faqe në gjendjen që ajo është. RATECH heq shprehimisht dorë nga të gjitha garancitë ose kushtet që lidhen me faqen, të cilat rrjedhin nga ligji ose nga burime të tjera, qofshin ato të shprehura apo të nënkuptuara, duke përfshirë garancitë ose kushtet e funksionimit, titullit, integritetit të të dhënave dhe përshtatshmërisë për qëllimin. RATECH nuk garanton që faqja nuk ka gabime apo që të gjitha gabimet do të korrigjohen.

10. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

10.1. Në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi, në asnjë rast RATECH nuk do të jetë përgjegjës për asnjë lloj dëmi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në fitimin e munguar, humbjen e informacionit konfidencial, ndërprerjen e aktivitetit, dëmet personale, humbjen e privatësisë, dështimin për të përmbushur ndonjë detyrim, si dhe çdo dëm tjetër që rrjedh ose që është i lidhur, në çfarëdo mënyre, me përdorimin ose pamundësinë për të përdorur faqen, edhe nëse RATECH është njoftuar për mundësinë e shkakimit të këtyre dëmëve. Nëse ju nuk jeni të kënaqur me ndonjë pjesë të faqes, mjeti juaj i vetëm ligjor është të ndërprisni përdorimin e saj.

10.2. Ju jeni përgjegjës për çdo rrezik që lidhet me përdorimin e faqes nga ana juaj. Faqja nuk është dizajnuar dhe nuk synon të zëvendësojë vlerësimin tuaj të pavarur.

11. DËMSHPËRBLIMI

11.1. Ju pranoni të dilni garant dhe të dëmshpërbleni RATECH për çdo pretendim, detyrim, kërkesë, gjobë, padi, vendim gjyqësor, kosto dhe shpenzim që mund t'i ngarkohet RATECH në lidhje me përdorimin e faqes nga ana juaj,

NUIS: L11521021S

përdorimin e informacioneve që ju dorëzoni nga ana e RATECH ose shkeljen e ndonjë dispozite të këtyre kushteve.

12. AFATI DHE ZGJIDHJA

12.1. Këto kushte rregullojnë përdorimin e faqes nga ana juaj për aq kohë sa ju ta përdorni atë.

12.2. Nëse ju shkelni ndonjë dispozitë të këtyre kushteve dhe nuk arrini të riparoni shkeljen e kryer brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për të, RATECH mund të ndërpresë menjëherë aksesin tuaj në faqe.

13. TË NDRYSHME

13.1. Ju nuk mund të transferoni, plotësisht apo pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet tuaja sipas këtyre kushteve.

13.2. Asnjë dispozitë e këtyre kushteve nuk mund të ndryshohet, përveç se me një dokument të shkruar të nënshkruar nga përfaqësues të autorizuar rregullisht të të dy palëve.

13.3. RATECH e administron këtë faqe nga Shqipëria. RATECH nuk bën asnjë përfaqësim që përmbajtja e kësaj faqeje është e ligjshme ose e përshtatshme për përdorim jashtë Shqipërisë. Ju lutemi, mbani parasysh se kjo faqe mund të mos jetë në përputhje me ligjet e vendit tuaj. Nëse hyni në këtë faqe nga jashtë Shqipërisë, ju e bëni këtë nën përgjegjësinë tuaj.

13.4. Hyrja dhe përdorimi nga ana juaj i faqes rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e shtetit shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me këto kushte, faqen, performancën ose përdorimin e faqes i nënshtrohen juridiksionit të shtetit shqiptar. Përdorimi i faqes është i paautorizuar në çdo juridiksion që nuk jep efekt për të gjitha dispozitat e këtyre kushteve.

13.5. Asnjëra palë nuk merr përsipër përgjegjësi ndaj palës tjetër për shkak të ndonjë humbjeje ose dëmi që rezulton nga ndonjë vonesë ose dështim për të kryer të gjitha ose ndonjë pjesë të këtyre kushteve, duke përfshirë detyrimet për pagesë, kur vonesa është shkaktuar, tërësisht ose pjesërisht, nga ngjarje ose shkaqe përtej kontrollit të arsyeshëm të palës.

13.6. Asnjë dështim për të zbatuar ndonjë nga këto kushte nuk do të interpretohet si heqje dorë nga të drejtat që rrjedhin prej tyre. Për më tepër, heqja dorë nga secila nga palët nga ndonjë e drejtë në ndonjë rast të caktuar nuk do të interpretohet si heqje dorë e vazhdueshme ose si heqje dorë në raste të tjera.

13.7. RATECH mund ta ndryshojë këtë faqe në çdo kohë dhe vazhdimi i përdorimit të faqes përbën marrëveshjen tuaj për këto ndryshime. Bazuar vetëm në gjykimin tonë, me apo pa njoftim paraprak, ne mund ta ndërpresim këtë faqe ose ndonjë pjesë të saj, të kufizojmë kohën kur faqja është në dispozicion ose të kufizojmë sasinë e përdorimit të lejuar. Ne mund të ndërpresim funksionimin e faqes, çdo pjesë të faqes ose ndonjë shërbim, produkt ose funksionalitet të disponueshëm në faqe, çdo herë që do të jetë e nevojshme për të kryer mirëmbajtje rutinë ose jo rutinë, korrigjimin e gabimit ose ndryshime të tjera.

13.8. RATECH i mirëpret reagimet dhe komentet tuaja për faqen dhe shërbimet tona. Megjithatë, ne nuk kërkojmë asnjë informacion, të cilin ju nuk keni të drejtë të ngarkoni, postoni, dërgoni me email ose ta transmetoni në mënyra të tjera, bazuar në ligj ose në ndonjë marrëdhënie kontraktore ose fiduciare (informacione të brendshme, informacione me të drejtë autori dhe konfidenciale, të mësuara ose të zbuluara si pjesë e marrëdhënieve të punës ose rregulluar nga marrëveshjet e konfidencialitetit). Duke ngarkuar, postuar e vendosur informacione të tilla në këtë faqe, ju i jepni RATECH të drejtën

e përhershme, të parevokueshme, të vlefshme në të gjithë botën, pa detyrim për të paguar tarifa, jo ekskluzive dhe plotësisht të transferueshme për të përdorur, shpërndarë, riprodhuar, modifikuar, përshtatur, përkthyer, shfaqur dhe pasqyruar publikisht dhe krijuar vepra që rrjedhin prej tyre, në punime të tjera në çdo format ose medium të njohur aktualisht apo të krijuar në të ardhem, për të cilat nuk mban asnjë përgjegjësi.

13.9. Me përjashtim të kërkesë-padisë për shpërblimin e dëmit, asnjëra palë nuk mund të ngrejë padi bazuar në këto kushte nëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga mbarimi i afatit të këtyre kushteve ose, në rast se ka ndodhur një shkelje e tyre, më shumë se 2 vjet nga koha e ndodhjes së shkeljes, ose, në rast se shkelja nuk është zbuluar nga pala e dëmtuar kur ka ndodhur, më shumë se 2 vjet nga koha e zbulimit të saj.